

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Ç. nga Prishtina, kundër të paditurës: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a, me seli në Prishtinë - tani Telekomi i Kosovës, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar H.I., për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2610/16, të datës 31.03.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë **12.12.2018**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Telekomi i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2610/16, i datës 31.03.2017, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2610/16, të datës 31.03.2017, në pjesën e parë të dispozitivit ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. Ç dhe të detyrohet pala e paditur Telekomi i Kosovës sh.a. Prishtinë, që më afatin kohor prej 15 ditëve, nga pranimi i aktgjykimit paditësit për periudhën kohore 01.02.2012 deri me 31.08.2015, t'ia kompensojnë diferencën në pagë, kontributet pensionale dhe tatimin në pagë në mes të gradës 7 dhe 8 në shumën e parave të specifikuar si më poshtë: në emër të pagës neto shumën e parave 3,904.50 €, në emër të kontributit pensional shumën e parave prej 456.67 €, në emër të tatimit në pagë në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 433.38 €, pastaj për kamatën e arritur për periudhën 01.02.2012, deri me datë 31.01.2017, shumën prej 238,66 euro. Ndërsa me pjesën e dytë të dispozitivit është detyruar pala e paditur që në afat kohor prej 15 ditësh, t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 150 euro.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës e të ndryshohet aktgjykimi i atakuar ashtu që të refuzohet si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit ose aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, me datën 26.04.2012, ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me kërkesë që të anulohet vendimi i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës në Prishtinë, si i pa bazë dhe i padrejtë dhe paditësit t'i kompensohet diferenca e pagës në ems të gradës 7 dhe 8, nga data 01.02.2012 (si datë e hyrjes në fuqi të vendimit kontestues) e deri në datën 01.09.2015 (si datë e rikthimit të pagës nga grada 8), në emër të pagës neto shumë e parave 3,904.50 €, në emër të kontributit pensional shumë e parave prej 456.67 €, në emër të tatimit në pagë në dobi të Buxhetit të Kosovës shumë prej 433.38 €, pastaj për kamatën e arritur për periudhën 01.02.2012, deri me datë 31.01.2017, në shumë prej 238,66 euro si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2610/2016, i datës 31.03.2017, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, të parashtruar, kundër të paditurës, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, në procedurën e të provuarit ka administruar prova dhe ka vërtetuar gjendjen faktike sipas të cilës është vërtetuar se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratën Nr.01-2880-2847/11, të datës 20.10.2011. Sipas kontratës së punës paditësi pranë të paditurës është caktuar në kryerjen e detyrave të punës si Kryetëknik në njesinë Telekomi i Kosovës, i cili do të kryej punët në lokacionin - Prishtinë. Sipas kontratës është përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë, për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 8. E paditura me vendimin me nr.01-1040-424/2012, i datës 07.03.2012 paditësit i është caktuar grada 7, sipas strukturës së gradave, duke i ulur paditësit gradën nga 8 në 7.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se për të paditurën vazhdon të jetë si çështje kontestuese sikurse baza juridike e kërkesëpadisë ashtu edhe lartësia e kërkesëpadisë, ndërsa duke ju referuar pretendimeve të palës së paditur të parashtruar në gjykim, vlerësoi se kontraktimi i bazës juridike të kërkesëpadisë është i paqëndrueshëm nga fakti se kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale nuk është vjetërsuar, pasi që në rastin konkret zbatohet dispozita e nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili parashef afatin tre vjeçar për realizimin e kërkesave në para. Duke marr parasysh se kundërligjshmëria e vendimit të palës së paditur me të cilin paditësit i është zvogëluar paga nga grada 8 në 7, është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.922/12, të datës 15.04.2014, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së

Apelit Ac.nr.2752/14, datë 27.10.2016, ku në këtë rast çështja është kthyer në rigjykim vetëm sa i përket detyrimit të të paditurës për pagesën e ndryshimit të pagës, bonusit dhe trustit, pasi që në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk ishte përcaktuar lartësia e pagesës e shprehur në para, lidhur me të lartëcekurat ka vlerësuar se paditësi ka pësuar dëm material në lartësinë e llogarisë si në ekspertizën financiare, prandaj në mbështetje të ekspertizës të cilës gjykata ja ka falur besimin në tërësi, është vendosur për detyrimin e të paditurës që paditësit t'ia kompensoj ndryshimin në pagë, kontributet pensionale dhe tatimin në pagë, shumën e parave të përshkruara si në paragrafi I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin e atakuar ju ka referuar nenit 55 dhe 87 të Ligjit të Punës e lidhur me nenin 277 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 449, 452.1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit është vërtetuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, nga se sipas saj dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar. Aktgjykimi i atakuar është mjaftë i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsyetimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e të paditurës lidhur me afatshmërinë e padisë së paditësit, për shkak se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212) saktësisht parashihet se *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Po ashtu edhe në bazë të nenit 372 të LMD-së, i cili ishte në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë, saktësisht është përcaktuar se kërkesat periodike parashkruhen 3-vjet, nga rrjedha e secilës dhënie të veçantë për pagesë andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të këtyre ligjeve rrjedh se padia e paditësit është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor

(këtë pikëpamje juridike e ka dhënë edhe Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin Rev.nr.90/2017, datë 21.04.2017).

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur, për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktet vendimtare për arsye se sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 8 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Sipas kontratës së punës me Nr.01-2880-2847/11, të datës 20.10.2011, paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënës, kanë lidhur këtë kontrata për kohë të pa caktuar, ku paditësit në këtë rast punëmarrësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 8. Mirëpo, paditësit me vendimin nr.01-1040-424/2012, i datës 07.03.2012, e paditura i cakton të ardhura personale mujore në lartësi të gradës 7 sipas strukturës së gradave, duke i ulur paditësit gradën nga 8 në 7, ndërsa të njëjtin vendim më vonë Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.922/12, të datës 15.04.2014, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.2752/14, datë 27.10.2016, e ka anuluar vendimi e të paditurës. Në periudhën kontestuese nga 01.02.2012 deri me 31.08.2012, paditësi ka kryer detyrat e punës si kryetëknik në njësinë Telekomit i Kosovës, duke realizuar të ardhurat në lartësi të gradës 7, por që në fakt do të duhej të realizonte në lartësi të gradës 8, rrethanë kjo e vërtetuar me vendimin e kontestuar dhe provat tjera prezent në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa për diferencën e të ardhurave në mes gradës 8 dhe 7, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka administruar ekspertizën e ekspertit financiar Aziz Berisha, në bazë të së cilës ka vërtetuar diferencën e të ardhurave të munguara për paditësin si është përshkruar saktë në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale me referencë në nenin 55 paragraf 1 të Ligjit të Punës, sepse sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 8 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Në këtë drejtim, është vlerësim i kësaj gjykate se kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Ministrisë, nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve, duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara. Gjithashtu nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me

kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Meqenëse e paditura me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar se ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike edhe kjo gjykatë erdhi në përfundim se ekziston detyrimi juridik-civil, ndaj paditësit për kompensimin e diferencës së pagës nga grada 8 në gradën 7, në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, e cila gjenë mbështetje në nenin 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se: *“kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij”*, dhe si rezultat i kësaj meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, e paditura ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së, ndërsa vendimi mbi kamatën është në përputhje me nenin 277 të LMD-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 dhe 201 parag.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2410/17, datë 12.12.2018**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Lumni Sallauka**